



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. _____ prot.

Tiranë më, _____.____.2022

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET**

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (referuar AZHBR), person juridik publik, krijuar me ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, me seli në Tiranë, Rruga “Muhamet Gjollësja”, nr. 56, e përfaqësuar Drejtore e Përgjithshme Zj. Eranda Selmanaj.

dhe

_____, person juridik privat me nr. NUIS _____, me seli në _____, përfaqësuar nga Administrator Zj/Z. _____.

Në mbështetje të Ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, VKM Nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, Ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” Nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, si dhe Marrëveshjes Sektoriale, palët e mësipërme lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi me qëllimin sigurimin dhe mbledhjen, përpunimin e çmimeve reale të tregut Shqiptar, në kuadër të Implementimit të Programit IPARD III, bazuar në projektet e dorëzuara pranë AZHBR.

**NENI 1
RËNDËSIA**

1.1 AZHBR, në zbatim dhe implementim të Programit IPARD III “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, si dhe bashkëpunimit institucional ndërmjet sektorit privat dhe atij publik, çmon të domosdoshëm dhe të rëndësishëm këtë bashkëpunim, pasi ndihmon në zbatimin sa më korrekt, eficient, të shpejtë dhe transparent, procesin e marrjes dhe finalizimit të çmimeve reale të tregut.

**NENI 2
OBJEKTI I MARRËVESHJES**

2.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi parashtron procedurat që do të ndiqen dhe do të udhëheqin procesin e sigurimit të çmimeve sipas kërkesave të AZHBR, si dhe shkëmbimit të informacionit.

2.2 Kjo marrëveshje do të përcaktojë rregullat dhe veprimet teknike për marrjen, dërgimin dhe shkëmbimin e çmime dhe kërkesave midis AZHBR dhe subjektit _____ me NUIS _____.

NENI 3 MËNYRAT E REALIZIMIT

Me anë të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi **AZHBR merr përsipër:**

1. Të ruajë konfidencialitetin e të dhënave të marra nga subjekti, bazuar në Ligjin mbi të dhënat tregtare.
2. Të mbajë në gatishmëri Sistemin elektronik të PRDB që të jetë i aksesueshëm për të gjithë 24/24 e 7/7.
3. Të reklamojë në faqen e saj web www.azhbr.gov.al emrin e subjektit dhe objektin e aktivitetit për të cilat ka dhënë informacion në mënyrë që të jetë i aksesueshëm nga të gjithë dhe mund të shfrytëzohet nga grupet e interesit të cilët synojnë të aplikojnë në programin IPARD dhe jo vetëm.
4. Të realizojë fushata informimi/ndërgjegjësimi me funksionalitetin dhe procedurat e përdorimit të sistemit elektronik të PRDB si dhe kriteret që duhen plotësuar për të pasur akses në këtë sistem. Gjithashtu, të publikojë në faqen e saj web www.azhbr.gov.al të gjitha dokumentet dhe udhëzimet e nevojshme.
5. Të nënshkruajë këtë “MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI” në rast se subjekti ka dërguar të gjitha dokumentet e nevojshme dhe plotëson kriteret për bashkëpunim dhe në rast të kundërt, të refuzojë nënshkrimin. Për çdo rast të njoftojë subjektin.
6. Të vlerësojë e të regjistrojë në sistemin e PRDB informacionin e dërguar nga subjektet i cili plotëson kriteret e përcaktuara.
7. Të japë shpjegime subjekteve për çdo pyetje e paqartësi që dërgohen me e-mail.
8. Të ofrojë suport teknik për përdoruesit e sistemit të nëpërmjet numrit jeshil 08008383 të vënë në dispozicion për këtë qëllim.
9. Nëse inicohet një pezullim me ndonjë nga subjektet e regjistruara, i gjithë informacioni i ofruar nga subjekti do të pezullohet në sistemin e RPDB.

Pala merr përsipër:

- a. Të regjistrohet në Sistemin elektronik të PRDB.
- b. Të paraqesë pranë AZHBR listën e çmimeve/ofertat të zërave/aseteve pa TVSH dhe brenda një afati të përcaktuar nga AZHBR.

- c. Të paraqesë pranë AZHBR listën e çmimeve/ofertat për zëra/asete vetëm për investime fusha e të cilëve janë të parashikuara në Ekstraktin e QKB në seksionin “Objekti i aktivitetit”.
- d. Lista e çmimeve të ketë periudhë vlefshmërie jo më pak se 1 (një) vit.
- e. Listat e çmimeve/ofertat, dokumentacioni dhe informacioni që dërgohen në AZHBR të përmbajnë Logon e subjektit (nëse disponon), të jenë të firmosur nga titullari ose personi i autorizuar dhe të vulosur me vulë të njomë ose vulë elektronike si dhe të jenë në formatin pdf.
- f. Të paraqesë autorizimin nga subjekti prodhues ose distributori për të drejtën e shitjes së produktit në rastin kur subjekti është importues/eksportues.
- g. Të regjistrojë çmimet/ofertat në Sistemin elektronik të Bazës së të dhënave ose t'i dërgojë ato së bashku me dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm me postë në format të printuar në adresën AZHBR, Rruga “Muhamet Gjollësja”, Nr. 6 ose me e-mail në adresën cmime.reference@azhbr.gov.al.
- h. Lejon AZHBR-në të regjistrojë çmimet/ofertat, informacionin e dërguar në Sistemin elektronik të PRDB.
- i. Lejon AZHBR-në të publikojë për efekt publiciteti emrin e subjektit dhe objektin e aktivitetit për të cilat ka dhënë informacion.

NENI 4 PIKAT E KONTAKTIT

- 4.1 Secila prej palëve do të caktojë një person kontakti përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëveshjes, me qëllim koordinimin e veprimeve për realizimin e saj, duke përfshirë numrin e telefonit, e-mail, NUIS si dhe adresën kryesore.

NENI 5 5 ZBATIMI I MARRËVESHJES DHE PROCEDURAT NË VIJIM

- 5.1 Zbatimi i plotë i marrëveshjes do të bëhet funksional para implementimit dhe ratifikimit të Programit IPARD III.

NENI 6 DISPOZITA TË FUNDIT

- 6.1 Kjo marrëveshje nënshkruhet paraprakisht nga subjekti dhe dërgohet në AZHBR. Pasi nënshkruhet nga AZHBR, i dërgohet subjektit.
- 6.2 Kjo marrëveshje pas nënshkrimit nga të dy palët, hyn në fuqi menjëherë.
- 6.3 Kjo marrëveshje do të lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe.

6.4 AZHBR dhe _____, do ta rishikojnë dhe përmirësojnë këtë Marrëveshje, sa herë që ka arsye të nevojshme nga secila prej palëve, me qëllim pasqyrimin mbi të, të ndryshimeve të nevojshme.

Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe (angleze).

Për AZHBR

Eranda Selmanaj

Drejtoreshë e Përgjithshme

Për subjektin _____

Administrator